LIGJ
Nr. 77/2026

PËR SHOQËRITË EVROPIANE TË BASHKËPUNIMIT (SHEB)[1]

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj përcakton rregullat, kriteret dhe procedurat për themelimin, regjistrimin, organizimin e brendshëm, funksionimin, administrimin, ristrukturimin dhe prishjen e shoqërive evropiane të bashkëpunimit, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe të drejtat e detyrimet e anëtarëve të tyre.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Dispozitat e këtij ligji zbatohen për shoqëritë evropiane të bashkëpunimit, që themelohen e ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 3
Forma e shoqërisë evropiane të bashkëpunimit

1. Një shoqëri evropiane bashkëpunimi mund të themelohet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë në formën e një shoqërie evropiane të bashkëpunimit (në vijim SHEB) sipas kushteve dhe mënyrës së përcaktuar në këtë ligj.
2. Kapitali i nënshkruar i një SHEB-i ndahet në kuota.
3. Numri i anëtarëve dhe kapitali i një SHEB-i janë të ndryshueshëm.
4. Me përjashtim të rasteve kur statuti i SHEB-it parashikon ndryshe, anëtarët e një SHEB-i do të mbajnë përgjegjësi deri në vlerën e kontributit të nënshkruar prej tyre.
5. Në rastet kur anëtarët e SHEB-it kanë përgjegjësi të kufizuar, emri i SHEB-it do të pasohet nga fjalët "me përgjegjësi të kufizuar".
6. SHEB-i ka për qëllim kryesor përmbushjen e nevojave të anëtarëve të saj dhe/ose zhvillimin e veprimtarive të tyre ekonomike e sociale, veçanërisht nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve për furnizim me mallra ose shërbime apo për kryerjen e punëve, si dhe përmes nxitjes së pjesëmarrjes së anëtarëve në veprimtari ekonomike të zhvilluara nga një ose më shumë SHEB-e dhe/ose shoqëri bashkëpunimi të themeluara në Republikën e Shqipërisë.
7. Një SHEB mund të zhvillojë aktivitetet e tij nëpërmjet një filiali.

---

[1] Ky ligj është përafruar plotësisht me Rregulloren (KE) nr. 1435/2003, të Këshillit, datë 18 gusht 2003, "Për Shoqëritë Evropiane të Bashkëpunimit (SHEB)", e ndryshuar. Numri CELEX 32003R1435, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 207, datë 18.03.2003, faqe 1–24.

8. Një SHEB nuk mund të ofrojë përfitimet e aktiviteteve të tij për subjekte joanëtare dhe as të lejojë pjesëmarrjen e tyre në veprimtarinë e saj, me përjashtim të rasteve kur statuti i saj parashikon ndryshe.

9. Një SHEB ka personalitet juridik.

10. Përfshirja e punonjësve në SHEB rregullohet sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e punës dhe të marrëveshjeve kolektive.

Neni 4
Themelimi

Një SHEB me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë mund të themelohet në një nga mënyrat e mëposhtme:

a) nga jo më pak se 5 persona fizikë, prej të cilëve të paktën njëri është rezident në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe të paktën një tjetër është rezident në një shtet tjetër anëtar të Bashkimit Evropian;

b) nga jo më pak se 5 persona, përfshirë persona fizikë dhe persona juridikë të rregulluar nga e drejta publike ose private, të themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë dhe të paktën një shteti tjetër anëtar të Bashkimit Evropian;

c) nga persona juridikë të themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë dhe të paktën një shteti tjetër anëtar të Bashkimit Evropian e që rregullohen përkatësisht nga legjislacioni i këtyre dy shteteve të ndryshme;

ç) nga një bashkim ndërmjet shoqërive të bashkëpunimit të themeluara sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë dhe të paktën një shteti tjetër anëtar të Bashkimit Evropian, me seli dhe zyrë qendrore brenda territorit të Bashkimit Evropian;

d) nëpërmjet shndërrimit të një shoqërie bashkëpunimi të themeluar në Republikën e Shqipërisë, që ka pasur për të paktën 2 vjet një degë të regjistruar në një shtet tjetër anëtar të Bashkimit Evropian.

Neni 5
Kapitali minimal

1. Kapitali i një SHEB-i shprehet në monedhën kombëtare. Megjithatë, një SHEB mund të shprehë kapitalin e tij në euro.

2. Kapitali i nënshkruar nuk duhet të jetë më pak se 30 000 (tridhjetë mijë) euro ose ekuivalenti në lekë në datën e themelimit.

3. Statuti i SHEB-it parashikon shumën nën të cilën kapitali i nënshkruar nuk mund të zvogëlohet si pasojë e shlyerjes së kuotave të anëtarëve, që largohen nga SHEB-i. Kjo shumë nuk mund të jetë më e vogël se shuma e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni. Afati i përcaktuar në nenin 17 të këtij ligji, sipas të cilit anëtarët që largohen nga SHEB-i kanë të drejtë për pagesë për pjesën e tij në kapitalin e nënshkruar, do të pezullohet për sa kohë që shlyerja do të ulte kapitalin e nënshkruar nën kufirin e përcaktuar.

4. Kapitali i SHEB-it mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të reja nga anëtarët ekzistues ose nëpërmjet pranimit të anëtarëve të rinj. Zvogëlimi i kapitalit realizohet nëpërmjet shlyerjes së plotë ose të pjesshme të kuotave të nënshkruara, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me statutin e SHEB-it.

5. Ndryshimet e kapitalit në përputhje me dispozitat e këtij ligji nuk përbëjnë ndryshim të statutit e nuk kërkojnë publikim apo regjistrim të veçantë pranë regjistrit tregtar.

Neni 6
Kapitali i SHEB-it

1. Kapitali i nënshkruar i një SHEB-i përfaqësohet nga kuotat e anëtarëve, të shprehura në monedhën zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Shoqëria mund të emetojë më shumë se një kategori kuotash.

2. Statuti mund të parashikojë që kategori të ndryshme kuotash të japin të drejta të ndryshme, në lidhje me shpërndarjen e fitimit. Kuotat që u japin anëtarëve të drejta të njëjta do të përbëjnë një klasë.

3. Kapitali mund të përbëhet vetëm nga kontribute që kanë vlerë të matshme ekonomikisht. Kontributet e anëtarëve nuk mund të jenë në punë apo në shërbime.

4. Kuotat do të mbahen nga anëtarë nominalisht të përcaktuar. Statuti duhet të përcaktojë se kuotat e së njëjtës klasë kanë vlerë nominale të njëjtë. Kuotat nuk mund të emetohen me një çmim më të ulët se vlera e tyre nominale.

5. Kuotat e fituara kundrejt kontributit në para duhet të shlyhen në masën jo më pak se 25 për qind të vlerës së tyre nominale në momentin e nënshkrimit. Pjesa e mbetur shlyhet brenda një afati prej 5 vjetësh nga data e nënshkrimit, me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një afat më të shkurtër.

6. Kuotat e fituara kundrejt kontributit në natyrë duhet të shlyhen plotësisht në momentin e nënshkrimit.

7. Për vlerësimin e kontributeve në natyrë zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar, që rregullojnë emërimin e audituesit dhe procedurat e vlerësimit për shoqëritë aksionare.

8. Statuti përcakton numrin minimal të kuotave që duhet të nënshkruhen me qëllim anëtarësimin në një SHEB. Statuti nuk mund të përmbajë dispozita që kushtëzojnë pranimin si anëtar me zotërimin e më shumë se një kuote në rastet kur parashikon që shumica e anëtarëve në asamblenë e përgjithshme duhet të jenë persona fizikë dhe kur përmban kushte të veçanta për pjesëmarrjen e anëtarëve në veprimtaritë e SHEB-it përmes zotërimit të kuotave.

9. Kur shqyrton pasqyrat financiare për vitin financiar, mbledhja e asamblesë së përgjithshme vjetore, me anë të një vendimi, konstaton shumën e kapitalit në fund të vitit financiar, si dhe ndryshimin e tij në krahasim me vitin financiar të mëparshëm.

Me propozimin e organit administrativ ose drejtues, kapitali i nënshkruar mund të zmadhohet nëpërmjet kapitalizimit të të gjithë ose një pjese të rezervave të disponueshme për shpërndarje, me vendim të asamblesë së përgjithshme, në përputhje me kërkesat për kuorum dhe shumicë të parashikuara për ndryshimin e statutit. Kuotat e reja ndahen ndërmjet anëtarëve në përpjesëtim me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin ekzistues.

10. Vlera nominale e kuotave mund të zmadhohet duke bashkuar kuotat ekzistuese. Në rastet kur një zmadhim i tillë kërkon kontribut shtesë nga anëtarët, në përputhje me dispozitat e statutit, vendimi merret nga mbledhja e asamblesë së përgjithshme sipas kërkesave të kuorumit dhe shumicës së nevojshme për ndryshimin e statutit.

11. Vlera nominale e kuotave mund të zvogëlohet duke i ndarë kuotat ekzistuese.

12. Në përputhje me statutin e me vendimin e marrë nga asambleja e përgjithshme ose organi drejtues ose administrativ, kuotat mund t'i transferohen ose t'i shiten një anëtari ose kujtdo që anëtarësohet.

13. Një SHEB nuk lejohet të nënshkruajë kuotat e veta, t'i blejë ato apo t'i pranojë si garanci, as drejtpërdrejt dhe as nëpërmjet një personi që vepron në emrin e tij, por për llogari të SHEB-it. Megjithatë, kuotat e një SHEB-i mund të pranohen si garanci në transaksionet e zakonshme të institucioneve të kredisë së SHEB-it.

Neni 7
Statuti

1. Për qëllimet e këtij ligji, statuti i një SHEB-i nënkupton aktin e themelimit dhe, kur hartohet si dokument më vete, statutin e SHEB-it.

2. Anëtarët themelues hartojnë statutin e SHEB-it me seli në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin shqiptar. Statuti hartohet me shkrim e nënshkruhet nga anëtarët themelues.

3. Dispozitat për themelimin e shoqërive aksionare në Republikën e Shqipërisë do të zbatohen edhe për themelimin e SHEB-it me seli në Republikën e Shqipërisë.

4. Statuti i SHEB-it duhet të përfshijë të paktën:

a) emrin e SHEB-it, të paraprirë ose të ndjekur nga shkurtesa "SHEB" dhe, sipas rastit, fjala "i kufizuar";

b) objektin e aktivitetit;

c) emrat e personave fizikë dhe juridikë, që janë anëtarë themelues të SHEB-it, duke treguar veprimtaritë dhe selitë e tyre;

ç) adresën e selisë së SHEB-it;

d) kushtet e procedurat për pranimin, përjashtimin dhe dorëheqjen e anëtarëve;

dh) të drejtat e detyrimet e anëtarëve dhe kategoritë e ndryshme të anëtarëve, nëse ka, dhe të drejtat e detyrimet e anëtarëve në secilën kategori;

e) vlerën nominale të kuotave të nënshkruara, shumën e kapitalit të nënshkruar dhe një tregues se kapitali është i ndryshueshëm;

ë) rregulla të veçanta lidhur me shumën që, sipas rastit, duhet t'i kalojë rezervës ligjore;

f) kompetencat e përgjegjësitë e anëtarëve të secilit prej organeve drejtuese;

g) dispozitat që rregullojnë emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të organeve drejtuese;

gj) kërkesat për shumicë dhe kuorum;

h) kohëzgjatjen e ekzistencës së shoqërisë, kur është me kohëzgjatje të kufizuar.

Neni 8

Selia

Selia e regjistruar e një SHEB-i në Republikën e Shqipërisë përcaktohet në statutin e saj.

Neni 9

Transferimi i selisë

1. Selia e një SHEB-i mund të transferohet në një shtet tjetër anëtar të Bashkimit Evropian, në përputhje me pikat 2 deri në 15 të këtij neni. Një transferim i tillë nuk sjell likuidimin e shoqërisë dhe as krijimin e një personi të ri juridik.

2. Organi drejtues ose administrues harton një propozim transferimi dhe e publikon atë në përputhje me nenin 14 të këtij ligji. Ky propozim duhet të tregojë emrin aktual, selinë dhe numrin e SHEB-it e do të përfshijë:

a) selinë e propozuar të SHEB-it;

b) statutin e SHEB-it, duke përfshirë, sipas rastit, emrin e saj të ri;

c) afatin kohor të propozuar për transferimin;

ç) çdo ndikim që transferimi mund të ketë në përfshirjen e punëmarrësve;

d) çdo të drejtë të parashikuar për mbrojtjen e anëtarëve, kreditorëve dhe zotëruesve të të drejtave të tjera.

3. Organi drejtues ose administrues harton një raport që shpjegon e justifikon aspektet ligjore dhe ekonomike, si dhe efektet e transferimit në punësim, dhe shpjegon pasojat e transferimit për anëtarët, kreditorët, punëmarrësit dhe zotëruesit e të drejtave të tjera.

4. Anëtarët, kreditorët dhe zotëruesit e të drejtave të tjera të një SHEB-i, si dhe çdo organ tjetër, që sipas ligjit mund ta ushtrojë këtë të drejtë, kanë të drejtë të paktën 1 muaj para mbledhjes së asamblesë së përgjithshme të thirrur për të vendosur për transferimin, të shqyrtojnë në selinë e SHEB-it propozimin e transferimit dhe raportin e hartuar sipas pikës 3 të këtij neni dhe, me kërkesë, të marrin kopje të këtyre dokumenteve pa pagesë.

5. Çdo anëtar që kundërshton vendimin e transferimit në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme ose në një mbledhje sektoriale ose të seksionit mund të paraqesë dorëheqjen e tij/saj brenda 2 muajve nga vendimi i mbledhjes së asamblesë së përgjithshme. Anëtarësimi përfundon në fund të vitit

financiar në të cilin është paraqitur dorëheqja; transferimi nuk hyn në fuqi në lidhje me atë anëtar. Dorëheqja i jep anëtarit të drejtën për shlyerjen e kuotave sipas kushteve të përcaktuara në nenet 5, pika 3, e 17 të këtij ligji.

6. Vendimi për transferim nuk mund të miratohet brenda 2 muajve pas publikimit të propozimit. Një vendim i tillë merret në përputhje me parashikimet e pikave 3 dhe 4, të nenit 62 të këtij ligji.

7. Para se autoriteti kompetent të lëshojë certifikatën e përmendur në pikën 8 të këtij neni, SHEB-i duhet t'i sigurojë atij që për çdo detyrim që lind para publikimit të propozimit të transferimit, interesat e kreditorëve dhe të zotëruesve të të drejtave të tjera lidhur me SHEB-in (përfshirë organet publike) janë mbrojtur në mënyrë të përshtatshme, në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga ligji i zbatueshëm.

8. Noteri lëshon një certifikatë, e cila vërteton përfundimin e veprimeve dhe të formaliteteve, që duhen kryer para transferimit.

9. Transferimi i selisë nuk prodhon efekte deri në paraqitjen e certifikatës së përmendur në pikën 8 të këtij neni dhe të dokumentacionit, që provon përmbushjen e formaliteteve të kërkuara sipas legjislacionit të shtetit pritës.

10. Transferimi i selisë së një SHEB-i dhe ndryshimi i statutit të saj prodhojnë efekte nga data në të cilën bëhet efektiv regjistrimi i SHEB-it në shtetin e ri të selisë, në përputhje me pikën 1, të nenit 13 të këtij ligji.

11. Fshirja e regjistrimit në regjistrin tregtar shqiptar bëhet vetëm pas marrjes së njoftimit nga organi shtetëror, që administron regjistrin në vendin e regjistrimit të ri.

12. Regjistrimi i ri dhe fshirja e regjistrimit të vjetër do të publikohen në përputhje me nenin 14 të këtij ligji.

13. Pas publikimit të regjistrimit të selisë së re të një SHEB-i, kjo seli mund të përdoret në marrëdhëniet me palët e treta. Deri në publikimin e fshirjes së regjistrimit nga regjistri tregtar në Shqipëri, kjo e fundit konsiderohet ende e vlefshme në marrëdhënie me palët e treta, përveç rasteve kur shoqëria provon se palët kanë qenë në dijeni të selisë së re.

Nëse SHEB-i ushtron veprimtari, që i nënshtrohet mbikëqyrjes financiare sipas legjislacionit shqiptar, e drejta për të kundërshtuar transferimin e selisë i njihet edhe autoritetit kompetent mbikëqyrës.

Transferimi i selisë mund të jetë objekt shqyrtimi gjyqësor.

14. Një SHEB nuk mund të transferojë selinë e tij nëse ndaj tij kanë nisur procedura likuidimi, duke përfshirë likuidimin vullnetar, falimentimin ose procedura të tjera të ngjashme.

15. Një SHEB që e ka transferuar selinë nga Shqipëria në një shtet anëtar konsiderohet, për çdo veprim juridik të lindur para transferimit, sikur ta ketë ende selinë në Shqipëri, edhe nëse ajo paditet pas kryerjes së transferimit.

Neni 10

Ligji i zbatueshëm

Një SHEB do të rregullohet:

a) nga ky ligj;

b) kur autorizohet shprehimisht nga ky ligj, nga dispozitat e statutit të saj;

Për çështjet që nuk rregullohen nga ky ligj ose për çështje që rregullohen vetëm pjesërisht nga ky ligj do të zbatohen:

i. aktet ligjore e nënligjore të miratuara nga Republika e Shqipërisë për zbatimin e masave të komunitetit evropian, që lidhen posaçërisht me SHEB-et;

ii. aktet ligjore e nënligjore, që zbatohen për një shoqëri bashkëpunimi të themeluar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë;

iii. dispozitat e statutit të saj në të njëjtën mënyrë sikurse zbatohen për një shoqëri bashkëpunimi të themeluar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 11

Parimi i mosdiskriminimit

Në përputhje me këtë ligj, një SHEB me seli në Republikën e Shqipërisë trajtohet si një shoqëri bashkëpunimi vendase.

Neni 12
Të dhënat e detyrueshme për regjistrim

1. Dispozitat që rregullojnë të dhënat e detyrueshme për regjistrim për shoqëritë aksionare zbatohen edhe për SHEB-in. Emri i SHEB-it duhet të paraprihet ose të pasohet nga shkurtesa "SHEB" dhe, kur është e nevojshme, edhe nga fjala "e kufizuar".

2. Vetëm SHEB-et mund të përfshijnë shkurtesa "SHEB" para ose pas emrit të tyre për të përcaktuar formën e tyre ligjore.

Neni 13
Kërkesat e regjistrimit e të deklarimit

1. Çdo SHEB regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me procedurat e parashikuara në legjislacionin në fuqi për regjistrimin e bizneseve.

2. Një SHEB nuk mund të regjistrohet nëse nuk është arritur një marrëveshje mbi parashikimet për përfshirjen e punëmarrësve, në përputhje me rregullat e pjesëmarrjes së punëmarrësve, sipas pikës 10, të nenit 3 të këtij ligji.

3. Për qëllime regjistrimi të një SHEB-i të themeluar nëpërmjet bashkimit, në rastet kur parashikohet pjesëmarrja e punëmarrësve në drejtim apo mbikëqyrje, duhet të jetë lidhur më parë një marrëveshje e posaçme mbi përfshirjen e punëmarrësve në përputhje me ligjin e zbatueshëm. Në mungesë të një marrëveshjeje të tillë, asnjëra nga shoqëritë pjesëmarrëse në bashkim nuk duhet të ketë qenë subjekt i rregullave për pjesëmarrjen e punëmarrësve në organet drejtuese apo mbikëqyrëse para regjistrimit të SHEB-it.

4. Statuti i SHEB-it nuk mund të jetë në kundërshtim me parashikimet për përfshirjen e punëmarrësve, të përcaktuara sipas marrëveshjes përkatëse. Në rast se këto parashikime ndryshojnë dhe bien në kundërshtim me dispozitat e statutit, ky i fundit duhet të ndryshohet për të reflektuar përfshirjen e punëmarrësve.

5. Për qëllime të publikimit të të dhënave dhe dokumenteve, SHEB-i u nënshtrohet rregullave të parashikuara për shoqëritë aksionare në legjislacionin në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, për aq sa nuk parashikohet ndryshe në këtë ligj.

Neni 14
Publikimi i dokumentacionit

1. Dokumentet dhe të dhënat e SHEB-it publikohen sipas mënyrës së parashikuar në ligjin për regjistrimin e bizneseve për subjektet me formë juridike të ngjashme me shoqëritë aksionare.

2. Për degët e një SHEB-i të regjistruara në territorin e Republikës së Shqipërisë, kur selia e saj ndodhet në një shtet tjetër anëtar, zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar që rregullojnë regjistrimin dhe publikimin e të dhënave për degët e shoqërive të huaja. Këshilli i Ministrave mund të miratojë rregulla të veçanta për regjistrimin e SHEB-eve, në përputhje me veçoritë e organizimit e të funksionimit të shoqërive të bashkëpunimit.

Neni 15
Fitimi i anëtarësisë

1. Me përjashtim të rasteve kur anëtarësia rrjedh si pasojë e bashkimit të shoqërive të bashkëpunimit sipas këtij ligji, pranimi si anëtar në një SHEB i nënshtrohet miratimit nga organi

drejtues ose i administrimit. Kërkuesit, kërkesa e të cilëve për anëtarësim është refuzuar, kanë të drejtë të paraqesin ankesë për shqyrtim në mbledhjen e radhës së asamblesë së përgjithshme.

Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon ndryshe, anëtarësimi në një SHEB mund të fitohet nga persona fizikë ose persona juridikë.

2. Statuti i SHEB-it mund të parashikojë kushte të veçanta për pranimin si anëtar, në veçanti:

a) zotërimin e një vlere minimale kuotash në kapitalin e shoqërisë së bashkëpunimit;

b) përputhshmërinë me objektin e veprimtarisë së shoqërisë.

3. Nëse parashikohet nga statuti, anëtarëve mund t'u kërkohet të nënshkruajnë kuota shtesë në kapitalin e shoqërisë së bashkëpunimit.

4. SHEB-i mban në selinë e saj një listë të anëtarëve, të renditur në mënyrë alfabetike, e cila përmban të dhënat identifikuese, adresat e tyre, si dhe numrin e klasën e kuotave që ata zotërojnë, sipas rastit.

Çdo person me interes të drejtpërdrejtë dhe të ligjshëm ka të drejtë të kërkojë të njihet me listën dhe të marrë një kopje të saj, të plotë ose të pjesshme, kundrejt një tarife, që nuk tejkalon kostot administrative.

5. Çdo transaksion që ndikon në mënyrën e caktimit, shpërndarjes, rritjes ose zvogëlimit të kapitalit duhet të regjistrohet në regjistrin e anëtarëve, të parashikuar në pikën 4 të këtij neni, brenda një muaji nga data e ndryshimit.

6. Transaksionet e parashikuara në pikën 5 të këtij neni nuk sjellin efekte ndaj SHEB-it apo ndaj palëve të treta me interes të drejtpërdrejtë dhe të ligjshëm, përpara se të jenë regjistruar në regjistrin e anëtarëve sipas pikës 4 të këtij neni.

7. Me kërkesë të anëtarit, shoqëria e bashkëpunimit lëshon një vërtetim me shkrim, që dëshmon se ndryshimi është regjistruar.

Neni 16

Humbja e anëtarësisë

1. Anëtarësia në një SHEB përfundon:

a) me dorëheqje;

b) me përjashtim kur anëtari ka kryer një shkelje të rëndë të detyrimeve të tij ose ka vepruar në kundërshtim me interesat e SHEB-it;

c) kur parashikohet nga statuti, pas transferimit të të gjitha pjesëve takuese që zotëron te një anëtar tjetër ose te një person fizik apo juridik, që ka fituar anëtarësimin;

ç) me prishje (likuidim) nëse anëtari është person juridik;

d) me nisjen e procedurës së falimentimit;

dh) me vdekjen e anëtarit;

e) në çdo rast tjetër të përcaktuar në statutin e shoqërisë ose në ligjin e zbatueshëm për shoqëritë e bashkëpunimit.

2. Çdo anëtar i pakicës, që ka kundërshtuar në asamblenë e përgjithshme një ndryshim të statutit, me të cilin:

a) janë vendosur detyrime të reja për pagesa ose shërbime të tjera;

b) janë zgjeruar ndjeshëm detyrimet ekzistuese të anëtarëve; ose

c) është zgjatur periudha e njoftimit për dorëheqje në më shumë se 5 vjet,

ka të drejtë të paraqesë dorëheqjen brenda 2 muajve nga data e miratimit të vendimit nga asambleja e përgjithshme.

Në rastet e parashikuara në shkronjat "a" dhe "b" të kësaj pike, anëtarësimi përfundon në mbyllje të vitit financiar në të cilin është paraqitur dorëheqja.

Në rastin e parashikuar në shkronjën "c" të kësaj pike, anëtarësimi përfundon me përfundimin e periudhës së njoftimit që ishte në fuqi përpara hyrjes në fuqi të ndryshimit të statutit. Ky ndryshim statuti nuk prodhon efekt ndaj anëtarit në fjalë.

3. Dorëheqja i jep anëtarit të drejtën për shlyerjen e pjesëve takuese, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 5, pika 3, dhe nenin 17 të këtij ligji.

4. Vendimi për përjashtimin e një anëtari merret nga organi drejtues ose administrativ, pasi anëtarit t'i jetë dhënë mundësia të shprehet. Kundër këtij vendimi anëtari ka të drejtë të paraqesë ankim në asamblenë e përgjithshme.

Neni 17
Të drejtat financiare të anëtarëve në rast të dorëheqjes ose të përjashtimit

1. Me përjashtim të rasteve kur transferohen kuotat dhe në përputhje me nenin 5 të këtij ligji, humbja e anëtarësisë i jep të drejtë anëtarit për t'u paguar për pjesën e tij në kapitalin e nënshkruar, të reduktuar proporcionalisht me çdo humbje, që është ngarkuar mbi kapitalin e SHEB-it.

2. Shumat që zbriten sipas pikës 1 të këtij neni përllogariten duke u bazuar në pasqyrat financiare për vitin financiar në të cilin ka lindur e drejta për rimbursim.

3. Statuti përcakton procedurat dhe kushtet për ushtrimin e së drejtës së dorëheqjes, si dhe afatin brenda të cilit duhet të kryhet rimbursimi, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 3 vjet. Në çdo rast, SHEB-i nuk është e detyruar të realizojë rimbursimin përpara se të kenë kaluar 6 muaj nga miratimi i pasqyrave financiare pas humbjes së anëtarësisë.

4. Pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni zbatohen, gjithashtu, edhe në rastet kur rimbursimi i kuotave i referohet vetëm një pjese të pjesëmarrjes së anëtarit në kapital.

KREU II
THEMELIMI

SEKSIONI 1
PARASHIKIME TË PËRGJITHSHME

Neni 18
Ligji i zbatueshëm për themelimin

1. Themelimi i një SHEB-i me seli në Republikën e Shqipërisë u nënshtrohet ligjeve të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë.

2. Regjistrimi i një SHEB-i bëhet publik në përputhje me nenin 14 të këtij ligji.

Neni 19
Personaliteti juridik

1. Një SHEB fiton personalitetin juridik në ditën e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar, në përputhje me parashikimet e nenit 13 të këtij ligji.

2. Në rast se përpara regjistrimit të një SHEB-i janë kryer veprime në emër të tij dhe SHEB-i kundërshton detyrimet që rrjedhin nga këto veprime pas regjistrimit të saj, personat fizikë, shoqëritë, sipërmarrjet ose entitetet e tjera ligjore, që i kanë kryer këto veprime, do të jenë përgjegjëse solidarisht dhe individualisht, pa kufizim, me përjashtim të rasteve kur është rënë dakord ndryshe me marrëveshje.

SEKSIONI 2
THEMELIMI NËPËRMJET BASHKIMIT

Neni 20
Procedurat për themelimin nëpërmjet bashkimit

1. Një SHEB mund të themelohet nëpërmjet një bashkimi të kryer, sipas:

a) procedurës së bashkimit me përthithje;

b) procedurës së bashkimit nëpërmjet krijimit të një personi të ri juridik.

2. Në rastin e bashkimit me përthithje, shoqëria e bashkëpunimit përthithëse merr formën e një SHEB-i në momentin e realizimit të bashkimit. Në rastin e bashkimit nëpërmjet krijimit të një personi të ri juridik, ky i fundit merr formën e një SHEB-i.

Neni 21
Ligji i zbatueshëm në rastin e bashkimit

Për çështjet që nuk rregullohen nga ky seksion ose kur ato rregullohen vetëm pjesërisht dhe për aspektet që nuk janë të mbuluara prej tij, çdo subjekt që merr pjesë në themelimin e një SHEB-i nëpërmjet bashkimit u nënshtrohet dispozitave të pjesës IX, "Për riorganizimin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqërive anonime", të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Neni 22
Kundërshtimi i bashkimit për arsye të interesit publik

1. Ministria përgjegjëse për ekonominë, pas konsultimit me institucionet rregullatore sipas fushës së veprimtarisë, mund të kundërshtojë pjesëmarrjen e një shoqërie bashkëpunimi në formimin e një SHEB-i me anë të bashkimit nëse vlerëson se ky bashkim cenon interesin publik.

2. Për efekt të zbatimit të pikës 1 të këtij neni, ministria udhëzon Qendrën Kombëtare të Biznesit që të pezullojë lëshimin e vërtetimit të ligjshmërisë përpara bashkimit.

3. Kundërshtimi i ministrisë duhet të jetë i arsyetuar dhe ndaj tij mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente administrative.

Neni 23
Projektmarrëveshja e bashkimit

1. Organet drejtuese ose të administrimit të shoqërive të bashkëpunimit pjesëmarrëse në bashkim hartojnë në bashkëpunim projektmarrëveshjen e bashkimit. Kjo projektmarrëveshje përmban të paktën të dhënat e mëposhtme:

a) emrin dhe selinë e shoqërive të bashkëpunimit që marrin pjesë në bashkim, si dhe emrin e selinë e propozuar për SHEB-in që do të krijohet;

b) raportin e këmbimit të kapitalit të nënshkruar në kuota dhe shumën e çdo kontributi shtesë në para; në rastet kur nuk ka kuota, ndarjen e saktë të aktiveve dhe vlerën e tyre të barasvlershme në kuotë;

c) rregullat për alokimin e kuotave në SHEB;

ç) datën nga e cila zotërimi i kuotave në SHEB i jep zotëruesit të drejtën për të përfituar nga shpërndarja e fitimit, si dhe çdo kusht të veçantë që ndikon në këtë të drejtë;

d) datën nga e cila veprimet tregtare të shoqërive të bashkëpunimit pjesëmarrëse në bashkim do të konsiderohen, për qëllime kontabël, si veprime të SHEB-it;

dh) kushtet ose përfitimet e veçanta që lidhen me instrumente financiare, të ndryshme nga kuotat, të cilat nuk i japin mbajtësit të drejtën për t'u bërë anëtar i SHEB-it, sipas përcaktimeve të nenit 65 të këtij ligji;

e) të drejtat që SHEB-i u jep zotëruesve të kuotave me të drejta të veçanta dhe zotëruesve të instrumenteve të tjera financiare përveç kuotave ose masat e propozuara në lidhje me to;

ë) masat për mbrojtjen e të drejtave të kreditorëve të shoqërive të bashkëpunimit, pjesëmarrëse në bashkim;

f) çdo përfitim i veçantë i dhënë ekspertëve, që shqyrtojnë projektmarrëveshjen e bashkimit ose anëtarëve të organeve drejtuese, administrative, mbikëqyrëse apo kontrolluese të shoqërive të bashkëpunimit pjesëmarrëse në bashkim;

g) statutin e propozuar të SHEB-it;

gj) informacionin për procedurat për përcaktimin e rregullimeve për përfshirjen e punëmarrësve, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

2. Shoqëritë e bashkëpunimit pjesëmarrëse në bashkim mund të përfshijnë edhe elemente të tjera në projektmarrëveshjen e bashkimit.

3. Dispozitat e pjesës IX, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, zbatohen në mënyrë të ngjashme për bashkimet ndërkufitare të shoqërive të bashkëpunimit, që synojnë krijimin e një SHEB-i me seli në Republikën e Shqipërisë.

Neni 24

Arsyetimi i projektmarrëveshjes së bashkimit

Organet administrative ose drejtuese të secilës shoqëri bashkëpunimi që bashkohet hartojnë një raport të detajuar me shkrim, që shpjegon e justifikon projektkushtet e bashkimit nga një këndvështrim ligjor dhe ekonomik e, në veçanti, raportin e këmbimit të kuotave. Raporti duhet të tregojë, gjithashtu, çdo vështirësi të veçantë vlerësimi.

Neni 25

Publikimi

1. Dispozitat e pjesës IX, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, zbatohen në mënyrë të ngjashme edhe në lidhje me kërkesat e regjistrimit e publikimit për shoqëritë e bashkëpunimit, që u nënshtrohen ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

2. Publikimi i projektmarrëveshjes së bashkimit në regjistrin tregtar përfshin të paktën elementet e mëposhtme për secilën nga shoqëritë e bashkëpunimit pjesëmarrëse në bashkim:

a) llojin, emrin dhe selinë e secilës shoqëri bashkëpunimi pjesëmarrëse në bashkim;

b) adresën e vendit ose regjistrit në të cilin depozitohen statuti dhe të gjitha dokumentet dhe detajet e tjera, në lidhje me secilën shoqëri bashkëpunimi pjesëmarrëse në bashkim dhe numri i regjistrimit në atë regjistër;

c) informacion për të drejtat dhe masat mbrojtëse të kreditorëve të shoqërisë së bashkëpunimit, të parashikuara në nenin 29 të këtij ligji, si dhe adresën ku mund të merret pa pagesë informacioni i plotë mbi to;

ç) informacion për të drejtat dhe masat mbrojtëse të anëtarëve të shoqërisë së bashkëpunimit, sipas parashikimeve përkatëse të legjislacionit të zbatueshëm për shoqëritë e bashkëpunimit, si dhe adresën ku mund të merret pa pagesë informacioni i plotë mbi to;

d) emrin dhe selinë e propozuar për SHEB-in;

dh) kushtet që përcaktojnë datën kur bashkimi do të hyjë në fuqi sipas nenit 32 të këtij ligji.

Neni 26

Detyrimi për të dhënë informacion

1. Çdo anëtar ka të drejtë që, jo më vonë se 1 muaj përpara datës së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, ku do të merret vendim për bashkimin, të njihet me dokumentet e mëposhtme në selinë e shoqërisë së bashkëpunimit:

a) projektmarrëveshjen e bashkimit;

b) pasqyrat financiare vjetore dhe raportet e organeve drejtuese të shoqërive të bashkëpunimit, që marrin pjesë në bashkim, për tre vjetët financiarë të fundit;

c) raportin e audituesit, në përputhje me dispozitat e pjesës IX, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar;

ç) raportin e audituesit mbi vlerën e kuotave që do të shpërndahen në këmbim të aseteve për shoqëritë e bashkëpunimit pjesëmarrëse në bashkim ose raportin e vlerësimit të kuotave, siç parashikohet në nenin 27 të këtij ligji;

d) raportin e arsyetimit të kushteve të projektmarrëveshjes së bashkimit, në përputhje me nenin 24 të këtij ligji.

2. Një kopje e plotë e dokumenteve të përmendura në pikën 1 të këtij neni ose një ekstrakt i tyre mund të merret me kërkesë të çdo anëtari pa pagesë.

Neni 27

Raporti i audituesit

1. Secila shoqëri bashkëpunimi pjesëmarrëse në bashkim emëron një ose më shumë auditues, në përputhje me dispozitat e pikës 7, të nenit 6 të këtij ligji, për shqyrtimin e projektmarrëveshjes së bashkimit dhe hartimin e një raporti në formë të shkruar për anëtarët.

2. Dispozitat e pjesës IX, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, zbatohen në mënyrë të ngjashme për bashkimet ndërkufitare të shoqërive të bashkëpunimit, që synojnë krijimin e një SHEB-i me seli në Republikën e Shqipërisë.

Neni 28

Miratimi i projektmarrëveshjes së bashkimit

1. Mbledhja e asamblesë së përgjithshme të secilës prej shoqërive të bashkëpunimit që bashkohen miraton projektmarrëveshjen e bashkimit.

2. Përfshirja e punëmarrësve në SHEB rregullohet me ligj të posaçëm. Asambleja e përgjithshme e secilës prej shoqërive të bashkëpunimit pjesëmarrëse në bashkim rezervon të drejtën që të kushtëzojë regjistrimin e SHEB-it me miratimin e shprehur të marrëveshjes për përfshirjen e punëmarrësve.

Neni 29

Ligji i zbatueshëm për themelimin nëpërmjet bashkimit

Dispozitat e pjesës IX, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, zbatohen në mënyrë të ngjashme për bashkimet ndërkufitare të shoqërive të bashkëpunimit, në lidhje me mbrojtjen e interesave të:

a) kreditorëve të shoqërive të bashkëpunimit që bashkohen;

b) zotëruesve të obligacioneve në shoqëritë e bashkëpunimit që bashkohen.

Neni 30

Shqyrtimi i procedurës së bashkimit

1. Ligjshmëria e procedurës së një bashkimi shqyrtohet në përputhje me dispozitat e pjesës IX, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, si dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi për regjistrimin e biznesit.

2. Noteri lëshon një vërtetim për përfundimin e veprimeve dhe të formaliteteve para bashkimit.

Neni 31

Shqyrtimi i ligjshmërisë së bashkimit

1. Ligjshmëria e një bashkimi për pjesën e procedurës që ka të bëjë me realizimin e bashkimit dhe themelimin e SHEB-it, shqyrtohet nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në përputhje me dispozitat e pjesës IX, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, si edhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi për regjistrimin e biznesit.

2. Për këtë qëllim, çdo shoqëri bashkëpunimi pjesëmarrëse në bashkim duhet t'i paraqesë Qendrës Kombëtare të Biznesit dokumentin e përmendur në pikën 2, të nenit 30 të këtij ligji, brenda 6 muajve nga lëshimi i tij, së bashku me një kopje të projektmarrëveshjes së bashkimit të miratuar nga shoqëria e bashkëpunimit në fjalë.

3. Qendra Kombëtare e Biznesit sigurohet që shoqëritë e bashkëpunimit pjesëmarrëse në bashkim të kenë miratuar projektmarrëveshjen e bashkimit me të njëjtat kushte, si edhe që parashikimet për përfshirjen e punëmarrësve të jenë përcaktuar në përputhje me ligjin e zbatueshëm.

4. Qendra Kombëtare e Biznesit sigurohet, gjithashtu, që SHEB-i të jetë themeluar në përputhje me kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë.

Neni 32
Regjistrimi i bashkimit

1. Një bashkim dhe themelim i njëkohshëm i një SHEB-i hyn në fuqi në datën kur SHEB-i regjistrohet në përputhje me pikën 1, të nenit 13 të këtij ligji.

2. SHEB-i nuk mund të regjistrohet derisa të kenë përfunduar të gjitha formalitetet e parashikuara në nenet 30 e 31 të këtij ligji.

Neni 33
Publikimi

Për secilën prej shoqërive të bashkëpunimit pjesëmarrëse në bashkim, përfundimi i bashkimit bëhet publik në përputhje me ligjin e zbatueshëm në shtetin anëtar përkatës.

Neni 34
Pasojat e bashkimit

1. Bashkimi i kryer në përputhje me shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 20 të këtij ligji, sjell pasojat e mëposhtme:

a) të gjitha asetet dhe detyrimet e secilës shoqëri bashkëpunimi që përthithet i transferohen shoqërisë përthithëse;

b) anëtarët e secilës shoqëri bashkëpunimi që përthithet bëhen anëtarë të shoqërisë përthithëse;

c) shoqëritë e bashkëpunimit që përthithen pushojnë së ekzistuari;

ç) shoqëria përthithëse merr formën e një SHEB-i.

2. Bashkimi i kryer në përputhje me shkronjën "b", të pikës 1, të nenit 20 të këtij ligji, sjell pasojat e mëposhtme:

a) të gjitha asetet dhe detyrimet e shoqërive të bashkëpunimit që bashkohen i transferohen SHEB-it;

b) anëtarët e shoqërive të bashkëpunimit që bashkohen bëhen anëtarë të SHEB-it;

c) shoqëritë e bashkëpunimit që bashkohen pushojnë së ekzistuari.

3. Dispozitat e pjesës IX, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, zbatohen në mënyrë të ngjashme për formalitetet e bashkimeve të shoqërive të bashkëpunimit sipas pikës 1 të këtij neni.

4. Të drejtat dhe detyrimet e shoqërive të bashkëpunimit pjesëmarrëse, që lidhen me kushtet individuale e kolektive të punës dhe që rrjedhin nga legjislacioni kombëtar, praktika ose kontratat e punës në fuqi në datën e regjistrimit, i kalojnë automatikisht SHEB-it në momentin e regjistrimit të

saj. Kjo dispozitë nuk zbatohet për të drejtën e përfaqësuesve të punëmarrësve për të marrë pjesë në mbledhjet e asamblesë së përgjithshme, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 59 të këtij ligji.

5. Pas regjistrimit të bashkimit, SHEB-i duhet të njoftojë menjëherë anëtarët e shoqërisë së bashkëpunimit që përthithet për faktin se ata janë regjistruar në regjistrin e anëtarëve të SHEB-it, si edhe për numrin e kuotave të tyre.

Neni 35
Vlefshmëria e bashkimit

1. Një bashkim, siç parashikohet në shkronjën "ç", të pikës 1, të nenit 4 të këtij ligji, nuk mund të shpallet i pavlefshëm pasi SHEB-i të jetë regjistruar.

2. Mungesa e shqyrtimit të ligjshmërisë së bashkimit, në përputhje me nenet 30 e 31 të këtij ligji, përbën një nga shkaqet për prishjen e SHEB-it, sipas parashikimeve të nenit 73 të këtij ligji.

SEKSIONI 3
SHNDËRRIMI I NJË SHOQËRIE BASHKËPUNIMI EKZISTUESE NË NJË SHEB

Neni 36
Procedurat për themelimin me anë të shndërrimit

1. Pavarësisht nga sa parashikohet në nenin 13 të këtij ligji, shndërrimi i një shoqërie bashkëpunimi në një SHEB nuk do të rezultojë në mbylljen e shoqërisë së bashkëpunimit ose në krijimin e një personi të ri juridik.

2. Selia nuk mund të transferohet nga Republika e Shqipërisë në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian, sipas nenit 9 të këtij ligji, në të njëjtën kohë me kryerjen e shndërrimit.

3. Organi i administrimit ose drejtuesi i shoqërisë së bashkëpunimit në fjalë harton projektmarrëveshjen e shndërrimit dhe një raport shpjegues, që arsyeton aspektet ligjore e ekonomike të procesit, pasojat e tij mbi marrëdhëniet e punës dhe pasqyron ndikimet që do të ketë shndërrimi në SHEB për anëtarët dhe punëmarrësit.

4. Projektmarrëveshja e shndërrimit bëhet publike në mënyrën e përcaktuar në titullin III, të pjesës IX, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

5. Përpara mbledhjes së asamblesë së përgjithshme të përmendur në pikën 6 të këtij neni, një ose më shumë auditues të pavarur, të emëruar në përputhje me ligjin në fuqi, duhet të vërtetojnë rast pas rasti se janë respektuar rregullat e parashikuara në shkronjën "b", të pikës 1, të nenit 23 të këtij ligji.

6. Mbledhja e asamblesë së përgjithshme të shoqërisë së bashkëpunimit në fjalë miraton projektmarrëveshjen e shndërrimit së bashku me statutin e SHEB-it.

7. Të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë së bashkëpunimit që do të shndërrohet, që lidhen me kushtet individuale e kolektive të punës dhe që rrjedhin nga legjislacioni kombëtar, praktika ose kontratat e punës në fuqi në datën e regjistrimit, i kalojnë automatikisht SHEB-it në momentin e regjistrimit të saj.

KREU III
ORGANIZIMI I SHEB-it

Neni 37
Organet e SHEB-it

Sipas kushteve të përcaktuara nga ky ligj, një SHEB do të përbëhet nga:

a) një asamble e përgjithshme; dhe

b) ose një organ mbikëqyrës dhe një organ drejtues (sistem me dy nivele), ose një organ me funksione administrimi (sistem me një nivel) në varësi të formës së miratuar në statut.

SEKSIONI 1
SISTEMI ME DY NIVELE

Neni 38
Funksionet e organit drejtues dhe emërimi i anëtarëve

1. Organi drejtues është përgjegjës për administrimin e SHEB-it dhe përfaqësimin e saj në marrëdhëniet dhe procedurat ligjore me palët e treta.

2. Anëtari ose anëtarët e organit drejtues emërohen dhe shkarkohen nga organi mbikëqyrës.

3. Anëtarët e organit drejtues nuk mund të jenë njëkohësisht edhe anëtarë të organit mbikëqyrës. Megjithatë, organi mbikëqyrës mund të emërojë një nga anëtarët e tij për të ushtruar funksionin e anëtarit të organit drejtues, në rast të një vendi të lirë. Gjatë kësaj periudhe, funksionet e personit përkatës si anëtar i organit mbikëqyrës pezullohen.

4. Numri i anëtarëve të organit drejtues ose rregullat për përcaktimin e tij pasqyrohen në statutin e SHEB-it.

Neni 39
Drejtimi dhe thirrja e mbledhjeve të organit drejtues

1. Organi drejtues zgjedh një kryetar nga anëtarët e tij në përputhje me statutin.

2. Kryetari thërret një mbledhje të organit drejtues sipas kushteve të përcaktuara në statut ose me iniciativën e tij, ose me kërkesë të një anëtari. Çdo kërkesë duhet të tregojë arsyet e thirrjes së mbledhjes. Nëse nuk është ndërmarrë asnjë veprim lidhur me një kërkesë të tillë brenda 15 ditëve, mbledhja e organit drejtues mund të thirret drejtpërdrejt nga anëtari/anëtarët që ka/kanë bërë kërkesën.

Neni 40
Funksionet e organit mbikëqyrës dhe emërimi i anëtarëve

1. Organi mbikëqyrës kontrollon detyrat e kryera nga organi drejtues. Organi mbikëqyrës nuk mund të ushtrojë vetë kompetencat e administrimit të SHEB-it. Organi mbikëqyrës nuk mund ta përfaqësojë SHEB-in në marrëdhëniet me palët e treta. Ai përfaqëson SHEB-in në marrëdhëniet me organin drejtues ose anëtarët e tij për çështje gjyqësore dhe për lidhjen, ndryshimin ose përfundimin e kontratave ndërmjet SHEB-it dhe anëtarëve të organit drejtues.

2. Anëtarët e organit mbikëqyrës emërohen dhe shkarkohen nga mbledhja e asamblesë së përgjithshme. Megjithatë, anëtarët e parë të organit mbikëqyrës mund të emërohen në statut. Kjo dispozitë zbatohet pa cenuar rregullat për përfshirjen dhe pjesëmarrjen e punëmarrësve në SHEB, të përcaktuara sipas legjislacionit të zbatueshëm.

3. Jo më shumë se një e katërta e vendeve të lira në organin mbikëqyrës mund të plotësohen nga anëtarë që nuk janë përdorues.

4. Statuti përcakton numrin e anëtarëve të organit mbikëqyrës ose rregullat për përcaktimin e tij.

Neni 41
E drejta për të dhënë informacion

1. Organi drejtues i raporton organit mbikëqyrës të paktën një herë në 3 muaj për progresin dhe zhvillimet që parashikohen në veprimtarinë e SHEB-it, duke marrë parasysh çdo informacion, lidhur me shoqëritë e kontrolluara nga SHEB-i, që mund të ndikojë ndjeshëm në ecurinë e veprimtarisë së SHEB-it.

2. Përveç informacionit që komunikohet rregullisht sipas pikës 1 të këtij neni, organi drejtues duhet t'i komunikojë menjëherë organit mbikëqyrës çdo informacion mbi ngjarjet që mund të kenë ndikim të konsiderueshëm në veprimtarinë e SHEB-it.

3. Organi mbikëqyrës mund t'i kërkojë organit drejtues të sigurojë çdo lloj informacioni që i nevojitet për të ushtruar mbikëqyrjen sipas pikës 1, të nenit 40 të këtij ligji.

4. Organi mbikëqyrës mund të kryejë ose të organizojë çdo hetim të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tij.

5. Çdo anëtar i organit mbikëqyrës ka të drejtë të shqyrtojë të gjitha informacionet, që i paraqiten organit mbikëqyrës.

Neni 42

Drejtimi dhe thirrja e mbledhjeve të organit mbikëqyrës

1. Organi mbikëqyrës zgjedh një kryetar nga anëtarët e tij. Nëse gjysma e anëtarëve emërohen nga punëmarrësit, vetëm një anëtar i emëruar nga mbledhja e asamblesë së përgjithshme mund të zgjidhet kryetar.

2. Kryetari thërret mbledhjen e organit mbikëqyrës sipas kushteve të përcaktuara në statut ose me iniciativën e tij/saj, ose me kërkesë të të paktën një të tretës së anëtarëve të tij, ose me kërkesë të organit drejtues. Kërkesa duhet të tregojë arsyet e thirrjes së mbledhjes. Nëse nuk është ndërmarrë asnjë veprim për këtë kërkesë brenda 15 ditëve, mbledhja e organit mbikëqyrës mund të thirret nga vetë personi që ka bërë kërkesën.

SEKSIONI 2
SISTEMI ME NJË NIVEL

Neni 43

Funksionet e organit të administrimit dhe emërimi i anëtarëve

1. Organi i administrimit administron SHEB-in dhe e përfaqëson atë në marrëdhëniet e në procedurat ligjore me palët e treta.

2. Numri i anëtarëve të organit të administrimit ose rregullat për emërimin e tyre përcaktohen në statutin e SHEB-it. Jo më shumë se një e katërta e vendeve të lira në organin e administrimit mund të zihen nga anëtarë që nuk janë përdorues. Megjithatë, organi i administrimit duhet të përbëhet nga të paktën 3 anëtarë punëmarrës të SHEB-it, pjesëmarrja e të cilëve rregullohet sipas përcaktimeve të këtij ligji.

3. Anëtarët e organit të administrimit dhe, kur parashikohet nga statuti, anëtarët e tyre zëvendësues emërohen nga mbledhja e asamblesë së përgjithshme. Megjithatë, anëtarët e parë të organit të administrimit mund të emërohen nga statuti. Kjo zbatohet pa cenuar asnjë parashikim të pjesëmarrjes së punëmarrësve të përcaktuar, në përputhje me ligjin e zbatueshëm për pjesëmarrjen e punëmarrësve në një SHEB.

Neni 44

Frekuenca e mbledhjeve dhe e drejta për informacion

1. Organi i administrimit mblidhet të paktën një herë në 3 muaj, në intervalet e përcaktuara në statut, për të diskutuar ecurinë dhe zhvillimin e parashikueshëm të veprimtarisë së SHEB-it, duke marrë parasysh, kur është e përshtatshme, çdo informacion lidhur me shoqëritë e kontrolluara nga SHEB-i, që mund të ndikojë ndjeshëm në ecurinë e veprimtarisë së SHEB-it.

2. Çdo anëtar i organit të administrimit ka të drejtë të shqyrtojë të gjitha raportet, dokumentet dhe informacionet që i paraqiten këtij organi.

Neni 45

Drejtimi dhe thirrja e mbledhjeve të organit të administrimit

1. Organi i administrimit zgjedh një kryetar nga anëtarët e tij. Nëse gjysma e anëtarëve emërohen nga punëmarrësit, vetëm një anëtar i emëruar nga mbledhja e asamblesë së përgjithshme mund të zgjidhet kryetar.

2. Kryetari thërret mbledhjen e organit të administrimit sipas kushteve të përcaktuara në statut ose me iniciativën e tij/saj, ose me kërkesë të të paktën një të tretës së anëtarëve të tij. Kërkesa duhet të tregojë arsyet e thirrjes së mbledhjes. Nëse nuk është ndërmarrë asnjë veprim për këtë kërkesë brenda 15 ditëve, mbledhja e organit të administrimit mund të thirret nga personi që ka bërë kërkesën.

SEKSIONI 3
RREGULLAT E PËRBASHKËTA PËR SISTEMET ME NJË DHE DY NIVELE

Neni 46
Mandati

1. Anëtarët e organeve të SHEB-it emërohen për një periudhë të përcaktuar në statut, që nuk i kalon 6 vjet.

2. Me përjashtim të çdo kufizimi të përcaktuar në statut, anëtarët mund të riemërohen një ose më shumë se një herë për periudhën e përcaktuar, në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

Neni 47
Kushtet e anëtarësimit

1. Asnjë person nuk mund të jetë anëtar i ndonjë organi të SHEB-it, nëse:

a) është i përjashtuar sipas ligjit shqiptar nga ushtrimi i funksioneve në organet drejtuese ose mbikëqyrëse të një shoqërie bashkëpunimi të rregulluar nga ky ligj; ose

b) është i përjashtuar nga ushtrimi i funksioneve në organet përkatëse të një shoqërie bashkëpunimi sipas një vendimi gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, të dhënë nga një autoritet kompetent i një shteti anëtar të Bashkimit Evropian.

2. Statuti mund të përcaktojë kushte të veçanta të përshtatshmërisë për anëtarët që përfaqësojnë organin e administrimit.

Neni 48
Kompetenca e përfaqësimit dhe përgjegjësia e SHEB-it

1. Në rastet kur kompetenca për të përfaqësuar SHEB-in në marrëdhëniet me palët e treta, në përputhje me nenet 38, pika 1, e 43, pika 1, të këtij ligji, u jepet dy ose më shumë anëtarëve të organit të administrimit, këta anëtarë e ushtrojnë këtë kompetencë bashkërisht.

2. Veprimet e kryera nga organet e një SHEB-i janë të detyrueshme për SHEB-in ndaj palëve të treta, edhe nëse këto veprime nuk përputhen me objektin e shoqërisë, për sa kohë që nuk tejkalojnë kompetencat që u janë dhënë organeve përkatëse nga ligji shqiptar ose që lejohet t'u delegohen sipas këtij ligji.

3. Kufizimet e kompetencave të organeve të SHEB-it, të përcaktuara në statutin e saj ose në vendime të organeve përkatëse, nuk mund t'u kundërdrejtohen palëve të treta, edhe nëse janë bërë publike.

Neni 49
Veprimet që kërkojnë autorizim

1. Statuti i një SHEB-i duhet të rendisë kategoritë e transaksioneve, që kërkojnë:

a) sipas sistemit me dy nivele, autorizim nga organi mbikëqyrës ose mbledhja e asamblesë së përgjithshme për organin drejtues;

b) sipas sistemit me një nivel, një vendim të shprehur të miratuar nga organi i administrimit ose autorizim nga mbledhja e asamblesë së përgjithshme.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet pa cenuar parashikimet në lidhje me kompetencat e organeve të SHEB-it, sipas nenit 48 të këtij ligji.

Neni 50
Konfidencialiteti

Anëtarët e organeve të një SHEB-i duhet të ruajnë konfidencialitetin për çdo informacion që kanë marrë në lidhje me SHEB-in edhe pas përfundimit të mandatit të tyre. Zbulimi i informacionit mund të dëmtojë interesat e shoqërisë së bashkëpunimit ose të anëtarëve të saj, përveç rasteve kur zbulimi kërkohet, ose lejohet nga dispozitat e ligjit të zbatueshëm për shoqëritë e bashkëpunimit ose shoqëritë tregtare, ose kur zbulimi është në interes publik.

Neni 51
Marrja e vendimeve nga organet e SHEB-it

1. Përveç rasteve kur ky ligj ose statuti parashikojnë ndryshe, rregullat e brendshme për kuorumin dhe vendimmarrjen në organet e SHEB-it janë, si më poshtë:

a) kuorumi: të paktën gjysma e anëtarëve me të drejtë vote duhet të jenë të pranishëm ose të përfaqësuar;

b) vendimmarrja: vendimet merren nga shumica e anëtarëve me të drejtë vote, që janë të pranishëm ose të përfaqësuar.

Anëtarët që nuk janë të pranishëm mund të marrin pjesë në vendimmarrje duke autorizuar një anëtar tjetër të organit ose një anëtar zëvendësues të emëruar njëkohësisht për t'i përfaqësuar.

2. Në mungesë të një parashikimi të shprehur në statut, kryetari i secilit organ ka të drejtën e votës vendimtare në rast barazie votash. Megjithatë, kjo e drejtë nuk zbatohet kur gjysma e anëtarëve të organit mbikëqyrës përbëhet nga përfaqësues të punëmarrësve, pavarësisht nga parashikimet e statutit.

Neni 52
Përgjegjësia civile

Anëtarët e organeve drejtuese, mbikëqyrëse dhe të administrimit janë përgjegjës, në përputhje me dispozitat që zbatohen për shoqëritë e bashkëpunimit në Republikën e Shqipërisë, për çdo humbje ose dëm të pësuar nga SHEB-i si pasojë e shkeljeve të detyrimeve ligjore, statutore ose shkeljeve të tjera që rrjedhin nga ushtrimi i detyrave të tyre.

SEKSIONI 4
MBLEDHJA E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

Neni 53
Kompetencat

1. Asambleja e përgjithshme vendos për çështjet që i janë rezervuar ekskluzivisht nga ky ligj.

2. Përveç çështjeve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, asambleja e përgjithshme vendos edhe për ato çështje që sipas ligjit të zbatueshëm për shoqëritë e bashkëpunimit ose statutit të

shoqërisë janë në kompetencën e saj, në përputhje me strukturën e parimet e veprimit të shoqërive të bashkëpunimit të regjistruara në Republikën e Shqipërisë.

Neni 54
Zhvillimi i mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme

Pa cenuar dispozitat e këtij seksioni, organizimi dhe zhvillimi i mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme të SHEB-ve me seli në Republikën e Shqipërisë, si dhe procedurat e votimit rregullohen nga ligji i zbatueshëm për shoqëritë e bashkëpunimit.

Neni 55
Mbledhjet e asamblesë së përgjithshme

1. SHEB-i është i detyruar të mbajë një mbledhje të asamblesë së përgjithshme të paktën një herë në vit, brenda 6 muajve nga përfundimi i vitit financiar.
2. Mbledhjet e asamblesë së përgjithshme mund të thirren në çdo kohë nga organi drejtues ose ai i administrimit, nga organi mbikëqyrës apo nga çdo organ, apo autoritet tjetër kompetent, në përputhje me ligjin e zbatueshëm për shoqëritë e bashkëpunimit. Organi drejtues është i detyruar të thërrasë një mbledhje të asamblesë së përgjithshme me kërkesë të organit mbikëqyrës.
3. Rendi i ditës i mbledhjes së asamblesë së përgjithshme që zhvillohet pas përfundimit të vitit financiar, duhet të përfshijë të paktën miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe shpërndarjen e fitimit.
4. Mbledhja e asamblesë së përgjithshme mund të vendosë gjatë zhvillimit të saj thirrjen e një mbledhjeje tjetër e të caktojë datën dhe rendin e ditës.

Neni 56
Thirrja e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme nga një pakicë anëtarësh

Anëtarët e SHEB-it, që së bashku përfaqësojnë më shumë se 5 000 anëtarë ose që zotërojnë të paktën 10% të numrit të përgjithshëm të votave, kanë të drejtë t'i kërkojnë SHEB-it thirrjen e një mbledhjeje të asamblesë së përgjithshme dhe të propozojnë rendin e ditës së saj. Statuti mund të parashikojë një numër më të vogël të anëtarëve ose përqindje më të ulët të votave.

Neni 57
Njoftimi për mbledhjen

1. Mbledhja e asamblesë së përgjithshme do të thirret nëpërmjet një njoftimi me shkrim, i cili u dërgohet me çdo mjet të përshtatshëm komunikimi të gjithë personave që kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhje, në përputhje me pikat 1 dhe 2, të nenit 59 të këtij ligji, si dhe me dispozitat e statutit. Njoftimi mund të publikohet, gjithashtu, në buletinin zyrtar të brendshëm të SHEB-it.
2. Njoftimi për thirrjen e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm:
a) emrin dhe adresën e selisë së SHEB-it;
b) vendin, datën dhe orën e mbajtjes së mbledhjes;
c) sipas rastit, llojin e mbledhjes;
ç) rendin e ditës, duke specifikuar çështjet që do të shqyrtohen dhe propozimet për vendimmarrje.
3. Periudha ndërmjet datës së dërgimit të njoftimit të përmendur në pikën 1 të këtij neni dhe datës së zhvillimit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme nuk duhet të jetë më pak se 30 ditë. Ky afat

mund të shkurtohet në jo më pak se 15 ditë në rrethana të jashtëzakonshme. Në rastet kur zbatohet pika 4, e nenit 62 të këtij ligji, për kërkesat për kuorum, periudha ndërmjet mbledhjes së parë dhe asaj të dytë, të thirrura për të njëjtin rend dite, mund të shkurtohet në përputhje me ligjin e zbatueshëm.

Neni 58
Shtesa në rendin e ditës

Anëtarët e SHEB-it, që së bashku përfaqësojnë më shumë se 5 000 persona ose të paktën 10% të numrit të përgjithshëm të votave, mund të kërkojnë që të përfshihen një ose më shumë pika shtesë në rendin e ditës të çdo mbledhjeje të asamblesë së përgjithshme. Statuti mund të parashikojë një numër më të vogël të anëtarëve ose përqindje më të ulët të votave.

Neni 59
Pjesëmarrja dhe përfaqësimi me prokurë

1. Çdo anëtar ka të drejtë të marrë pjesë dhe të votojë në mbledhjet e asamblesë së përgjithshme për çështjet e përfshira në rendin e ditës.
2. Anëtarët e organeve të SHEB-it, mbajtësit e titujve, përveç kuotave dhe obligacioneve, sipas nenit 65 të këtij ligji, si dhe, nëse parashikohet nga statuti, çdo person tjetër që ka të drejtë të marrë pjesë në bazë të ligjit të zbatueshëm, mund të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme pa të drejtë vote.
3. Çdo person me të drejtë vote mund të përfaqësohet në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një përfaqësues me prokurë, në përputhje me procedurat e përcaktuara në statut. Statuti përcakton numrin maksimal të personave që mund të përfaqësohen nga i njëjti përfaqësues.
4. Statuti mund të parashikojë, gjithashtu, mundësinë e votimit me postë ose të votimit elektronik, duke përcaktuar në këtë rast procedurat për realizimin e tyre.

Neni 60
E drejta e votës

1. Çdo anëtar i SHEB-it ka të drejtën e një vote, pavarësisht numrit të kuotave që zotëron.
2. Lidhur me të drejtat e votës së anëtarëve investitorë sipas statutit, SHEB-i me seli në Shqipëri do të veprojë në përputhje me legjislacionin shqiptar. Megjithatë, anëtarët investitorë nuk mund të zotërojnë së bashku më shumë se 25% të të drejtave të përgjithshme të votimit.

Neni 61
E drejta për informim

1. Çdo anëtar që kërkon informacion gjatë një mbledhjeje të asamblesë së përgjithshme, ka të drejtë të marrë përgjigje nga organi drejtues ose i administrimit për çështjet e SHEB-it, që lidhen me pikat e rendit të ditës të asaj mbledhjeje, në përputhje me pikën 1, të nenit 62 të këtij ligji. Për aq sa është e mundur, informacioni duhet të jepet në të njëjtën mbledhje të asamblesë së përgjithshme.
2. Organi drejtues ose i administrimit mund të refuzojë dhënien e informacionit vetëm në rastet, kur:
a) ekziston një rrezik i qenësishëm që informacioni të shkaktojë dëm të konsiderueshëm për SHEB-in;
b) zbulimi i informacionit do të ishte në kundërshtim me detyrimin ligjor për ruajtjen e konfidencialitetit.

3. Një anëtar, të cilit i është refuzuar informacioni, mund të kërkojë që pyetja e tij dhe arsyet e refuzimit të shënohen në procesverbalin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme.

4. Brenda 10 ditëve para mbledhjes së asamblesë së përgjithshme të thirrur për miratimin e pasqyrave financiare, anëtarët kanë të drejtë të shqyrtojnë bilancin, llogarinë e fitimeve dhe të humbjeve me shënimet shpjeguese, raportin e veprimtarisë, përfundimin e auditimit të llogarive nga personi përgjegjës dhe, në rastin e një shoqërie mëmë, në përputhje me pjesën VII, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, edhe pasqyrat financiare të konsoliduara.

Neni 62
Vendimet

1. Mbledhja e asamblesë së përgjithshme merr vendime lidhur me pikat e rendit të ditës. Ajo, gjithashtu, merr vendime për pikat që janë shtuar në rendin e ditës nga një pakicë anëtarësh, në përputhje me nenin 58 të këtij ligji.

2. Vendimet në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme merren me shumicën e votave të vlefshme të anëtarëve të pranishëm ose të përfaqësuar.

3. Statuti përcakton kërkesat që do të zbatohen në mbledhjet e asamblesë së përgjithshme për kuorumin dhe shumicën.

Kur statuti parashikon mundësinë që një SHEB të pranojë anëtarë investitorë ose të ndajë të drejtat e votës sipas kontributit të kapitalit në SHEB-të, që ushtrojnë aktivitete financiare ose sigurimi, ai do të përcaktojë edhe kërkesa të veçanta për kuorumin lidhur me anëtarët e tjerë, përveç anëtarëve investitorë ose atyre me të drejta vote të bazuara në kontributin e kapitalit në këto SHEB-e.

4. Një mbledhje e asamblesë së përgjithshme mund të ndryshojë statutin në mbledhjen e parë të thirrur vetëm nëse anëtarët e pranishëm ose të përfaqësuar përbëjnë të paktën gjysmën e numrit të përgjithshëm të anëtarëve në datën e thirrjes. Në mbledhjen e dytë, e thirrur për të njëjtin rend dite, kuorumi nuk kërkohet.

5. Në rastet e përmendura në pikën 4 të këtij neni, vendimi duhet të miratohet me shumicën e të paktën dy të tretave të votave të vlefshme.

Neni 63
Procesverbali

1. Për çdo mbledhje të asamblesë së përgjithshme do të mbahet një procesverbal. Procesverbali duhet të përfshijë të paktën të dhënat e mëposhtme:

a) vendin dhe datën e mbledhjes;

b) vendimet e miratuara;

c) rezultatin e votimit.

2. Procesverbalit i bashkëlidhen lista e pjesëmarrësve, dokumentet që lidhen me thirrjen e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme dhe raportet e paraqitura anëtarëve për pikat e rendit të ditës.

3. Procesverbali dhe dokumentet bashkëlidhur tij duhet të ruhen për të paktën 5 vjet. Çdo anëtar mund të kërkojë një kopje të procesverbalit dhe dokumenteve bashkëlidhur, duke mbuluar kostot administrative për marrjen e tyre.

4. Procesverbali duhet të nënshkruhet nga kryetari i mbledhjes.

Neni 64
Mbledhjet e sektorit ose të seksionit

1. Kur një SHEB ushtron veprimtari të ndryshme ose veprimtari në më shumë se një njësi territoriale, ose ka disa njësi të veçanta organizative, ose më shumë se 500 anëtarë, statuti mund të

parashikojë krijimin e mbledhjeve sektoriale ose të seksioneve. Statuti përcakton ndarjen sipas sektorëve apo të seksioneve dhe numrin e të deleguarve për secilin prej tyre.

2. Mbledhjet sektoriale apo të seksioneve zgjedhin të deleguarit e tyre për një mandat maksimal prej 4 vjetësh, me përjashtim të rasteve kur parashikohet shkarkimi i parakohshëm. Të deleguarit e zgjedhur përbëjnë asamblenë e përgjithshme të SHEB-it dhe përfaqësojnë në të sektorin apo seksionin përkatës, të cilit i raportojnë për rezultatet e mbledhjes së përgjithshme. Dispozitat e seksionit 4, të kreut III të këtij ligji zbatohen edhe për funksionimin e mbledhjeve sektoriale dhe të seksioneve.

KREU IV
EMETIMI I KUOTAVE ME TË DREJTA TË VEÇANTA

Neni 65
Kuotat e veçanta

1. Statuti i SHEB-it mund të parashikojë, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm për tregjet e kapitalit, emetimin e instrumenteve të veçanta financiare, përfshirë titujt të borxhit, të tillë si obligacionet, të cilët nuk japin të drejtë vote. Këto instrumente mund të nënshkruhen nga anëtarët ose nga persona të tjerë që nuk janë anëtarë. Blerja e tyre nuk u jep mbajtësve statusin e anëtarit. Statuti ose, sipas rastit, dokumentet e emetimit përcaktojnë procedurën për shlyerjen e tyre.

2. Mbajtësve të instrumenteve të përmendura në pikën 1 të këtij neni mund t'u jepen avantazhe të veçanta, në përputhje me dispozitat e statutit ose me kushtet e përcaktuara gjatë emetimit.

3. Vlera totale nominale e instrumenteve, të përmendura në pikën 1 të këtij neni, që mbahen nga i njëjti individ, nuk mund të tejkalojë shumën maksimale të përcaktuar në statut.

4. Pa cenuar të drejtën e pjesëmarrjes në Asamblenë e Përgjithshme, sipas parashikimeve të nenit 59 të këtij ligji, statuti mund të parashikojë mbajtjen e mbledhjeve të veçanta të mbajtësve të instrumenteve financiare të përmendura në pikën 1 të këtij neni.

5. Para se Asambleja e Përgjithshme të marrë ndonjë vendim, që prek të drejtat apo interesat e mbajtësve të instrumenteve financiare, mbledhja e veçantë mund të japë një mendim, i cili i komunikohet Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur.

6. Mendimi i mbledhjes së veçantë duhet të përfshihet në procesverbalin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

KREU V
NDARJA E FITIMEVE

Neni 66
Rezervat ligjore

1. Pa rënë ndesh me ligjin e zbatueshëm, statuti përcakton rregullat për shpërndarjen e fitimit për çdo vit financiar.

2. Statuti parashikon krijimin e një rezerve ligjore nëpërmjet derdhjes në këtë fond të fitimit të realizuar gjatë vitit financiar paraardhës. Deri në momentin kur kjo rezervë të arrijë vlerën e kapitalit të përcaktuar në pikën 2, të nenit 5 të këtij ligji, statuti duhet të parashikojë që jo më pak se 15% e fitimit të vitit financiar, pas zbritjes së humbjeve të mbartura, të alokohet për këtë qëllim.

3. Anëtarët që largohen nga SHEB-i nuk mund të ngrenë asnjë pretendim mbi shumën e caktuar për rezervën ligjore.

Neni 67
Dividendët

Statuti mund të parashikojë që shpërndarja e dividendëve ndërmjet anëtarëve të kryhet në përpjesëtim me vëllimin e veprimtarisë së tyre me SHEB-in ose në bazë të shërbimeve të kryera prej tyre në favor të SHEB-it.

Neni 68
Shpërndarja e tepricës së disponueshme

1. Gjendja e tepricës, pas zbritjes së shumave të caktuara për rezervën ligjore, dividendëve të paguar dhe humbjeve të mbartura, si dhe pas shtimit të çdo teprice të mbartur nga vitet e mëparshme dhe të çdo shume të tërhequr nga rezervat, përbën fitimin e disponueshëm për shpërndarje.

2. Mbledhja e asamblesë së përgjithshme, me rastin e miratimit të pasqyrave financiare vjetore, mund të vendosë për shpërndarjen e këtij fitimi, në përputhje me rendin dhe përmasat e përcaktuara në statut. Në veçanti, ajo mund të vendosë, që:

a) ta mbartë tepricën në vitin pasardhës;

b) ta ndajë atë në fondet rezervë ligjore ose statutore;

c) të shpërndahet si përfitim mbi kapitalin e paguar dhe/ose mbi mjetet e tjera të barasvlershme me kapitalin (*quasi-capital*), në formë monetare ose në kuota.

3. Statuti, gjithashtu, mund të parashikojë ndalime për shpërndarjen e fitimit.

KREU VI
PASQYRAT FINANCIARE VJETORE DHE PASQYRAT E KONSOLIDUARA

Neni 69
Përgatitja e pasqyrave financiare vjetore dhe të atyre të konsoliduara

1. Për qëllime të hartimit të pasqyrave financiare vjetore dhe pasqyrave të konsoliduara, përfshirë raportin vjetor shoqërues, si dhe auditimin dhe publikimin e tyre, SHEB-i u nënshtrohet dispozitave ligjore të zbatueshme për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

2. SHEB-i harton pasqyrat financiare vjetore dhe, në rast se ka, edhe pasqyrat e saj të konsoliduara në monedhën vendase.

Neni 70
Pasqyrat financiare të SHEB-eve që ushtrojnë aktivitete krediti ose financiare

1. SHEB-i që ushtron veprimtari si institucion krediti ose financiar u nënshtrohet dispozitave të ligjit të zbatueshëm për themelimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve të kreditit, duke përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe, sipas rastit, të pasqyrave të konsoliduara, raportin vjetor shoqërues, si dhe auditimin e publikimin e këtyre pasqyrave.

2. SHEB-i që ushtron veprimtari si shoqëri sigurimi u nënshtrohet dispozitave të ligjit të zbatueshëm për shoqëritë e sigurimit, në lidhje me përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe, sipas rastit, të pasqyrave të konsoliduara, përfshirë raportin vjetor shoqërues, si dhe auditimin e publikimin e këtyre pasqyrave.

Neni 71
Auditimi

Auditimi i pasqyrave financiare vjetore dhe, sipas rastit, i pasqyrave të konsoliduara të një SHEB-i kryhet në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm për auditimin ligjor.

KREU VII

PRISHJA, LIKUIDIMI, FALIMENTIMI DHE PAAFTËSIA PAGUESE

Neni 72
Prishja, likuidimi, falimentimi dhe procedurat e ngjashme

Prishja, likuidimi, falimentimi, paaftësia paguese dhe procedurat e ngjashme për SHEB-et u nënshtrohen procedurave të parashikuara në ligjin për falimentimin, si dhe dispozitave përkatëse të ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

Neni 73
Prishja e SHEB-it

1. Selia e regjistruar e një SHEB-i duhet të përkojë me vendndodhjen ku ushtrohen funksionet kryesore të administrimit të saj, përfshirë vendndodhjen e organeve ekzekutive dhe mbajtjen e dokumentacionit të shoqërisë. Nëse QKB-ja konstaton se kjo vendndodhje (drejtimi qendror) e një SHEB-i, me seli të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, është transferuar në një shtet tjetër, ajo i kërkon SHEB-it që brenda një afati të arsyeshëm të përcaktuar prej saj të rikthejë drejtimin qendror në territorin e Republikës së Shqipërisë ose të fillojë procedurat për transferimin e selisë së regjistruar në një shtet tjetër, në përputhje me nenin 9 të këtij ligji.

2. Kërkesa e QKB-së, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të përmbajë një përshkrim të qartë të rrethanave që e justifikojnë atë dhe të përfshijë shprehimisht njoftimin se në rast të moszbatimit nga ana e SHEB-it, do të pasojë kërkesa për fillimin e procedurave të likuidimit të detyruar.

3. Nëse SHEB-i nuk vepron në përputhje me kërkesën e QKB-së brenda afatit të përcaktuar, QKB-ja i drejtohet gjykatës kompetente me kërkesë për fillimin e procedurave të likuidimit të detyruar të SHEB-it. Njëkohësisht, QKB-ja bën shënimin përkatës në regjistrin tregtar, që pasqyron paraqitjen e kësaj kërkese.

4. Përveç sa parashikohet në pikat 1 deri në 3 të këtij neni, çdo person i interesuar ose Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) mund të paraqesë kërkesë në gjykatën kompetente për prishjen e një SHEB-i, kur konstatohet se:

a) ka shkelje të dispozitave të nenit 4 të këtij ligji dhe/ose të pikës 2, të nenit 5 të këtij ligji, si dhe në rastet e parashikuara nga neni 35 i këtij ligji; ose

b) SHEB-i ka më pak se tre anëtarë për një periudhë të pandërprerë prej 6 muajsh.

5. Vendimi i gjykatës për prishjen e SHEB-it regjistrohet në regjistrin tregtar dhe hyn në fuqi menjëherë pas regjistrimit. Çdo SHEB, që prishet me vendim gjykate, në përputhje me këtë nen, i nënshtrohet likuidimit të detyruar.

Neni 74
Publikimi i prishjes

Pa cenuar dispozitat e legjislacionit të zbatueshëm, lidhur me detyrimet për regjistrim e publikim, fillimi dhe përfundimi i procedurave të likuidimit, përfshirë likuidimin vullnetar, falimentimin apo paaftësinë paguese, si dhe çdo vendim për vazhdimin e veprimtarisë, duhet të publikohet në përputhje me nenin 14 të këtij ligji.

Neni 75
Shpërndarja

Pas shlyerjes së të gjitha detyrimeve ndaj kreditorëve dhe rimbursimit të kontributeve të anëtarëve në kapital, aktivet e mbetura të SHEB-it shpërndahen në përputhje me parimin e mosfitimit vetjak. Për qëllimet e këtij neni, aktivet e mbetura përfshijnë çdo pasuri të mbetur në zotërim të SHEB-it pas

përmbushjes së detyrimeve financiare dhe kthimit të kapitalit të anëtarëve. Nëse statuti i shoqërisë nuk parashikon ndryshe, këto aktive shpërndahen ndërmjet anëtarëve në përpjesëtim me veprimtarinë e bashkëpunimit të ndërsjellë të zhvilluar nga secili prej tyre.

Neni 76
Shndërrimi në shoqëri bashkëpunimi

1. Një SHEB mund të shndërrohet në një shoqëri bashkëpunimi të rregulluar nga ligji i zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë. Vendimi për shndërrimin nuk mund të merret përpara përfundimit të një periudhe 2-vjeçare nga data e regjistrimit të saj ose përpara miratimit të dy grupeve të para të pasqyrave financiare vjetore.

2. Shndërrimi i një SHEB-i në shoqëri bashkëpunimi nuk sjell likuidimin e saj dhe as krijimin e një personi të ri juridik.

3. Organi drejtues ose i administrimit të SHEB-it harton projektmarrëveshjen e shndërrimit, si dhe një raport që shpjegon dhe arsyeton aspektet juridike dhe ekonomike të shndërrimit, pasojat e tij në marrëdhëniet e punës, si dhe pasojat e shndërrimit për anëtarët, mbajtësit e kuotave të përmendur në nenin 16 të këtij ligji dhe për punëmarrësit.

4. Projektmarrëveshja e shndërrimit bëhet publike të paktën një muaj përpara mbledhjes së asamblesë së përgjithshme të thirrur për të vendosur mbi shndërrimin.

5. Përpara mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, të përmendur në pikën 6 të këtij neni, një ose më shumë auditues të emëruar nga autoriteti kompetent verifikojnë që SHEB-i, që transformohet në shoqëri bashkëpunimi, zotëron pasuri të paktën të barasvlershme me kapitalin e saj.

6. Mbledhja e asamblesë së përgjithshme e SHEB-it miraton projektmarrëveshjen e shndërrimit, së bashku me statutin e shoqërisë së bashkëpunimit. Vendimi merret në përputhje me legjislacionin shqiptar për shoqëritë tregtare.

KREU VIII
DISPOZITA SHTESË

Neni 77
Monedha e kapitalit dhe e pasqyrave financiare

1. Një SHEB me seli të regjistruar në territorin e Republikës së Shqipërisë shpreh kapitalin e saj në lekë. Statuti mund të parashikojë, gjithashtu, që kapitali të shprehet edhe në euro, kur kjo është e nevojshme për qëllime të raportimit financiar ose për bashkëpunim ndërkufitar. Në këtë rast, kursi i këmbimit i përdorur për konvertimin nga "lekë" në "euro" është ai i ditës së fundit të muajit paraardhës të datës së regjistrimit të SHEB-it, sipas të dhënave zyrtare të Bankës së Shqipërisë.

2. SHEB-i përgatit e publikon pasqyrat e saj financiare vjetore dhe, kur është e aplikueshme, pasqyrat e konsoliduara në lekë, siç kërkohet për shoqëritë aksionare, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

KREU IX
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 78
Shfuqizime në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian

1. Në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, të gjitha dispozitat e këtij ligji shfuqizohen pasi nga ajo datë SHEB-et e themeluara në territorin e Republikës së Shqipërisë u nënshtrohen drejtpërdrejt Rregullores (KE) nr. 1435/2003 të Këshillit, datë 22 korrik 2003, "Për Statutin e Shoqërisë Evropiane Kooperative (SCE)", dhe akteve të tjera të BE-së në fuqi për këtë qëllim.

2. SHEB-et e regjistruara para datës së anëtarësimit vazhdojnë ekzistencën e tyre juridike pa ndërprerje, si shoqëri evropiane të bashkëpunimit në kuptim të rregullores së përmendur në pikën 1 të këtij neni.

Neni 79

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.7.2026

Shpallur me dekretin nr. 462, datë 31.7.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.